**VENDIM**
**Nr.353, datë 29.4.2020**

# PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.327, DATË 28.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT DHE MËNYRËS SË MBLEDHJES E TË RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, PUBLIK OSE PRIVAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3, të nenit 30, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr.10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.17/2018, "Për statistikat zyrtare", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.327, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 9 shfuqizohet.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Ofruesit e shërbimit të kujdesit shëndetësor, publik ose privat, raportojnë të dhëna në sistemin e informacionit shëndetësor, sipas përcaktimeve në vendimin nr.135, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10".".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**